

Mbrojtja e të dhënave personale dhe dhënia e pëlqimit

Në mënyrë që të vijoni marrjen e këtij shërbimi, kërkohet që të plotësohen në formën e aplikimit online të dhënat personale si: emër, mbiemër, numër telefoni & celulari dhe adresë email-i, si dhe informacioni që do të vendosni në rubrikat e kësaj faqeje.

Mbrojtja e të dhënave personale

Albsig e konsideron mbrojtjen e privatësisë dhe të të dhënave tuaja personale si çështje shumë të rëndësishme dhe është i përkushtuar të zbatojë kuadrin ligjor në mbrojtje dhe respektim të tyre, të parashikuar nga Ligji nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, si dhe Rregullorja Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR).

Informacion i detajuar për kategorinë e të dhënave që përpunohen, qëllimet, kriteret e përpunimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale gjenden në faqen e internetit të Albsig <https://www.albsig.al>, menuja "Politikat e Privatësisë", në linkun:

<https://www.albsig.al/politikat-e-privatesise/>

Përdoruesi konfirmon plotësimin dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë dhe deklaron gjithashtu se ka plotësuar në mënyrë korrekte dhe të vërtetë të tërë informacionin e kërkuar.

Dhënie Pëlqimi

Me plotësimin e rubrikave në këtë faqe, përdoruesi deklaron se jep miratimin e tij për përpunimin e mëtejshëm të informacionit të dhënë prej tij nga Albsig, vetëm për qëllimin e përdorimit të shërbimit për të cilin përdoruesi ka deklaruar vullnetarisht të dhënat e tij personale.

Në çdo moment pasi përdoruesi të ketë dhënë vullnetarisht informacionin e kërkuar në këto fusha specifike, përdoruesit i lind e drejta që, nëpërmjet një kërkesë pranë Albsig, të aksesojë këto të dhëna, si dhe të kërkojë bllokimin, korrigjimin apo fshirjen e tyre në përputhje me parashikimet e bëra në Ligjin nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe GDPR.

Nëse ju tërhiqeni nga ky aplikim, para se të klikoni butonin "Dërgo Mesazhin", duke mos dashur të vijoni më tej, në këtë rast të dhënat tuaja personale nuk ruhen nga Albsig. Të dhënat tuaja personale do të ruhen vetëm në kuadër të marrëdhënies që keni si klient me Albsig. Për çdo ankesë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, mund t'i drejtoheni "Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".